



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
 - * Aktivitetet tjera

Janar, 2018

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Shqyrtimi Fillestar, Shqyrtimi i Dytë dhe Shqyrtimi Gjyqësor

Më 18 janar 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Shqyrtimi Fillestar, Shqyrtimi i Dytë dhe Shqyrtimi Gjyqësor”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të përfituesve për zbatimin e drejtë të procedurave specifike, lidhur me shqyrtimin fillestar, shqyrtimin e dytë dhe shqyrtimin gjyqësor, në funksion të zbatimit në mënyrë efikase të procedurës penale.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua shqyrtimi fillestar dhe shqyrtimi i dytë, afatet e caktimit të shqyrtimit fillestar pas pranimit të aktakuzës dhe shqyrtimit të dytë, veprimet e kryetarit të trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm gjykues

dhe rrjedha e shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë.

Paraprakisht, u elaboruan kriteret me rastin e pranimit të fajësisë, opsionet pas pranimit të fajësisë dhe rastet e veçimit të procedurës kur ka më shumë të pandehur dhe disa prej tyre e pranojnë fajësinë në shqyrtimin fillestar e disa të tjerë jo. Trajnimi u fokusua edhe në trajtimin e shqyrtimit gjyqësor, si një ndër fazat me të rëndësishme të procedurës penale, fazat e shqyrtimit gjyqësor, detyrat dhe veprimet e kryetarit të trupit gjykues apo gjyqtarit të vetëm gjykues në shqyrtimin gjyqësor, si dhe ndërprerja dhe shtyrja e shqyrtimit gjyqësor.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga të gjitha regjionet e Kosovës.



“Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës”

Më 23 janar 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV, ka realizuar trajnimin me temë “Shqyrtimi kryesor dhe marrja e provës”. Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me shqyrtimin kryesor dhe marrjen e provës, si fazë e rëndësishme e procedurës kontestimore.

Në këtë trajnim gjyqtarët arritën të avancojnë shkathtësitë për mbajtjen e shqyrtimit kryesor; të identifikojnë mjetet provuese në procedurën civile, të vlerësojnë faktet që duhet të provohen dhe ato që nuk duhet të provohen në procedurën civile, përfshirë këtu edhe autorizimet e gjykatës se kur mund të marrë prova zyrtarisht (ex officio), të zbatojnë drejtë dispozitat ligjore lidhur me kohën e propozimit dhe paraqitjes së provave si dhe barrën e të provuarit.

Në trajnim gjithashtu u konkludua se shqyrtimi kryesor është faza më e rëndësishme e procedurës kontestimore. Kjo fazë është pjesa qendrore e tërë procedurës kontestimore në të cilën bëhet edhe marrja e provave për të vendosur meritorisht në një çështje konkrete, siç përcaktohet me Ligjin e Procedurës Kontestimore, për obligimet e palëve

ndërgjyqëse që të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e veta. Në të provuarit përfshihen të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit, ndërsa gjykata vendos se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare.

Në hollësi u sqaruan dilemat të cilat po i përcjellin gjyqtarët në praktikë duke zbërthyer procedurën e cila zhvillohet nga gjykata në shqyrtimin kryesor, marrjen e provave apo mënyrën e të provuarit, sepse në praktikë ka vështirësi lidhur me atë se si duhet të zhvillohet procedura e të provuarit, dhe kur gjykata është e autorizuar që t’i marrë edhe provat që nuk i kanë propozuar palët, po që se konstaton se palët tentojnë të disponojnë me kërkesa me të cilat nuk kanë të drejtë të disponojnë.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe të përcjella me shembuj praktik.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit (divizioni civil) si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave



Veprat penale kundër narkotikëve

Më 25 janar 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Veprat penale kundër narkotikëve”.



Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i shkathtësive profesionale të përfituesve të trajnimit, në zbatimin e drejtë të Kodit Penal si dhe të Kodit të Procedurës Penale kur kemi të bëjmë me

hetimin dhe gjykimin e veprave penale kundër narkotikëve.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan veprat penale kundër narkotikëve dhe substancave psikotrope duke përfshirë edhe elementet e këtyre veprave penale. Vëmendje parësore iu kushtua përkufizimit si dhe llojeve të narkotikëve të rrezikshëm dhe substancave psikotrope. Njëkohësisht, u trajtuan rastet nga praktika gjyqësore, si dhe shkëmbimi i përvojave me qëllim të eliminimit të dilemave të cilat shfaqen në praktikë, kur kemi të bëjmë me këto vepra penale të cilat përbejnë një rrezikshmëri të madhe për shoqërinë në tërësi.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Zhvillimi i drejtë i procedurës sipas Ligjit për Kundërvajtje, procedimi i provave në procedurën kundërvajtëse, fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse

Më 30 janar 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temën “Zhvillimi i drejtë i procedurës sipas Ligjit për Kundërvajtje, procedimi i provave në procedurën kundërvajtëse, fillimi dhe zhvillimi i procedurës kundërvajtëse”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me risitë e Ligjit për Kundërvajtje dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore, që kanë të bëjnë me fillimin dhe zhvillimin e procedurës kundërvajtëse.

Në fokus të trajnimit ishte trajtimi i kushteve për përcaktimin e kundërvajtjeve dhe sanksioneve për kundërvajtje, përgjegjësia kundërvajtëse dhe masat e veçanta të kundërvajtjes, procedura për të mitur sipas këtij ligji, dallimi në mes të provave të pranueshme dhe të papranueshme si dhe kuptimi i provës dhe faktit.

Pjesa e pasdites ka trajtuar kushtet ligjore për fillimin e procedurës kundërvajtëse dhe veprimet e gjykatës pas pranimit të kërkesës, me theks të veçantë fillimi dhe zhvillimi i procedurës për kundërvajtje tek veprat kundërvajtëse të kryera në vazhdimësi dhe bashkimi i tyre.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësi të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikën gjyqësore aktuale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: gjyqtarë nga gjykatat themelore, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Kundërvajtje.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në PTF për gjyqtarët e sapoemëruar

Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë muajit janar ka zhvilluar disa aktivitete në drejtim të përmbushjes së programit trajnuese, duke përfshirë trajnimin teorik, trajnimin praktik si dhe vizitat në institucione jo-gjyqësore.



Në këtë periudhë janë realizuar 16 sesione trajnimi nga nën-modulet “Kontrolli dhe konfiskimi” (1), “Administrimi i procedurës penale” (2), “Provat në procedurën penale” (6), “Parashkrimi” (3), “Shqyrtimi fillestar, i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor” (3), “Provat në procedurën penale” (6), dhe “Procedurat e veçanta sipas KPPK-së” (1).

Në kuadër të këtyre nën moduleve janë trajtuar konfiskimi sipas kompetencave të zgjeruara, burimi i provës dhe mjetet provues, marrja e provës para dhe pas fillimit formal të hetimit dhe pranueshmëria e tyre, mënyra e marrjes së provës nga dëshmitarët dhe ekspertët neni 123 të KPPK, prova të papranueshme, provat sipas kapitullit XVI të Kodit të Procedurës Penale si dhe rregullat e përgjithshme për vlerësimin e provave. Gjithashtu janë trajtuar parashkresat, afatet si dhe marrja dhe komunikimi i

vendimeve, dërgimi i shkresave, ekzekutimi i vendimeve dhe dispozitat tjera, shqyrtimi fillestar, marrëveshja për pranimin e fajësisë, pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe shqiptimi i dënimit, kundërshtimi i provave, kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe shqyrtimi i dytë. Po ashtu një rëndësi e veçantë gjatë këtyre trajnimeve i është kushtuar edhe procedurës ndaj personave të cilët kanë kryer vepra penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës, dhe procedurat penale ku përfshihen kryerësit me çrregullime mendore dhe paraburgimi i tyre.

Në kuadër të modulit Kodi Penal është trajtuar parashkrimi – natyra juridike e tij, mos zbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale në kundër të drejtës ndërkombëtare dhe vrasjes së rëndë dhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit.

Metodologjia e aplikuar gjatë realizimit të këtyre sesioneve trajnuese ishte e kombinuar, duke përfshirë ligjërime teorike dhe diskutime interaktive, ku gjyqtarët e sapoemëruar ngritën çështje me interes dhe dilema të cilat po ashtu i vërejnë gjatë fazës praktike të trajnimit në gjykatat përkatëse. Përmes detyrave dhe ushtrimeve praktike, ata u angazhuan në përgatitjen dhe prezantimin e rasteve për situata të ndryshme hipotetike.

Në kuadër të trajnimit praktikë, gjyqtarët e sapoemëruar kanë vazhduar praktikën në gjykatat përkatëse konform orarit të përcaktuar me program, nën mbikëqyrjen e mentorëve të tyre. Po ashtu, gjyqtarët e sapoemëruar, gjatë kësaj periudhe, kanë realizuar trajnimin me Qendrën për Punë Sociale.

Trajnim praktik për gjyqtarët e sapoemëruar në Qendrën për Punë Sociale

Më 30 janar 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Qendrën për Punë Sociale në Prishtinë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët e



sapoemëruar të njohohen me rolin, funksionin dhe përgjegjësitë e Qendrës për Punë Sociale.

Në fokus të trajnimit ishte roli i Qendrës për Punë Sociale lidhur me veprimtaritë e saj, përfshirë ofrimin e përkujdesjes dhe mirëqenies sociale, mbrojtjen, strehimin dhe

parandalimin e dhunës në familje, Anamnezën apo mbledhjen e të dhënave të personave që u ofrohet ndihma, si dhe realizimi i kontaktit të fëmijës/ve me prindërit nëse është marrë vendim nga gjykata që fëmijët të bëjnë realizimin e kontakteve përmes QPS-së.

Gjatë vizitës u shtjellua edhe çështja e adoptimit të fëmijëve, kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë prindërit adoptues për të adoptuar një fëmijë, të drejtat e fëmijëve të braktisur kur të arrijnë moshën madhore (18) vjet për t'i kërkuar prindërit e braktisur, si dhe ruajtja e informatave nga QPS-së.

Po ashtu pjesëmarrësit u informuan në mënyrë të detajuar për kategoritë e përfituese, që i trajton QPS-ja dhe shërbimet që ajo i ofron, si dhe vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet në përbushjen e përgjegjësisë të saj.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapoemëruar të shtetit gjenerata e VI-të e PTF-së.



Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

Takimi i Këshillit të Redaksisë

Me 04 janar 2018, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i radhës së Këshillit të Redaksisë së publikimeve të Akademisë, për revistën “Justicia”.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi përbashkët i Këshillit të Redaksisë për punimet hulumtuese të prokurorëve të sapo emëruar të cilët ndjekin Trajnimin Fillestar në Akademinë e Drejtësisë, të cilat kanë qenë në vlerësim si dhe përzgjedhja e temave të cilat kanë

plotësuar kriteret për publikim në revistën “Justicia”.

Me rastin e këtij takimi janë prezantuar punimet një nga një para dhe pas rishikimit të kërkuar nga komentet dhe rekomandimet e redaktuesit. Më tej pas diskutimeve të përbashkëta është bërë vlerësimi përfundimtar për punimet, si dhe është vendosë për artikujt për publikim në revistën “Justicia” duke marrë për bazë kriteret për publikim.



Tryezë diskutimi me gjyqtarë

Me 26 janar 2018, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të Projektit për Reformë Ligjore dhe Administrative të GIZ, ka realizuar një tryezë me gjyqtarë me temë “Identifikimi i nevojave lidhur me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe si të zbatohen ato në punën e përditshme të gjyqtarëve”.

Qëllimi i kësaj tryeze ishte identifikimi i nevojave të gjyqtarëve lidhur me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe hartimi i një përmbledhje të rasteve nga kjo gjykatë, bazuar në rëndësinë e rasteve, dhe veçanërisht ato që kanë vendosë parimet kryesore të kësaj gjykate.

Ekspertët e angazhuar nga radhët e profesorëve të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në hartimin e kësaj përmbledhje, vunë në pah vështirësitë për qasjen e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat edhe pse janë publike duke qenë se janë në gjuhën frënge dhe angleze bëjnë të pamundur referimin nga gjykatat tona. Po ashtu, në të shumtën e rasteve janë tepër voluminoze prandaj, përmbledhja e rasteve me çështjet kryesore do ta lehtësonte punën e

gjyqtarëve dhe referimin në vendimet e kësaj gjykate.

Me rastin e kësaj tryeze, kontribut të rëndësishëm në selektimin e temave ofruan gjyqtarët pjesëmarrës duke parashtruar nevojat e tyre në çështjet më sfiduese si: çështjet e pronës, çështjet trashëgimore, çështjet e diskriminimit, kompensimi i kërkesave kur është kufizuar liria e shprehjes, kohëzgjatja e hetimeve, ushtrimi i fesë dhe shumë çështje tjera.

Në përfundim të kësaj tryeze, në bazë të kërkesave u konkludua se përmbledhja do të përmbajë për secilin nen të Konventës nga 6-7 raste. Po ashtu, me rastin e hartimit të kësaj përmbledhje, do të përcillen rastet e vitit 2017 për Shqipërinë duke eliminuar përmbledhjet tjera që janë të përkthyer.

Përveç nevojës për një përmbledhje të tillë gjyqtarët pjesëmarrës parashtruan edhe nevojën e një trajnimit për referimin e rasteve.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin gjyqtarët nga gjitha gjykatat themelore duke përfshirë edhe Gjykatën e Apelit.



Aktivitetet tjera

Takimi i tetë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, 17 janar 2018 – Është mbajtur takimi i tetë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues, Kryeprokurori i Shtetit z. Aleksandër Lumezi.

Gjatë këtij takimi, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues, fillimisht u miratua agjenda e takimit dhe procesverbalet e dy takimeve të kaluara.

Në vazhdim, Këshilli Drejtues miratoi Planin e Punës së Akademisë së Drejtësisë për vitin 2018, duke theksuar se ky plan e përmbush mandatin ligjor dhe objektivat e punës së Akademisë.

Më pas Këshilli Drejtues, mori vendim për kompensimin e mentorëve për gjyqtarët dhe

prokurorët e ri, në programin e trajnimit fillestar për vitin 2018.

Në këtë takim KD shqyrtoi dhe miratoi listën e mentorëve të propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës për gjyqtarët e sapoemëruar, si dhe vendosi për kompensimin anëtarëve të redaksisë së revistës Justicia.

Anëtarët e Këshillit Drejtues unanimisht u pajtuan me propozimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës që prokurorët e sapoemëruar të vazhdojnë Programin e Trajnimit Fillestar të njëjtë sikur vitin e kaluar.

Këshilli Drejtues i Akademisë së Drejtësisë në fund të takimit diskutoi edhe për tema të ndryshme që kanë të bëjnë me punën dhe funksionimin e mirëfilltë të Akademisë.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**